REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 33/17
Date/Datum. 13.02.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

REFERENCË:	**33/17**
PËR:	- Zyrtarin e prokurimit të AK-së: **Universiteti i Prishtinës** - Parashtruesit të ankesës: **"Pharmachem"-Dega në Kosovë** - Prishtinë.
CC:	- Panelit Shqyrtues në OSHP, - Arkivës në OSHP
NGA:	Sabrie Spahiu - Eksperte Teknike e Prokurimit Burim Guri - Ekspert Shqyrtues i Prokurimit
TEMA:	Raporti i vlerësimit të ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar: **"Pharmachem"-Dega në Kosovë** - Prishtinë, me numër protokollit: **33/17**, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me Pisje Laboratorike dhe Paisje të tjera për nevojat e UP-së" Lot 4, me nr. të prokurimit: 90400/16/022/111.** Kundër vendimit të Autoriteti Kontraktues: (AK) – **Universiteti i Prishtinës.**

Lokacioni:	Prishtinë	Data:	**13.02.2017**
PËR AKTIVITET			X
SIÇ ËSHTË KËRKUAR			X
PËR KOMENTE			X
PËR INFORMIMIN TUAJ			X

Bazuar në nenin 113 dhe 114 të LPP të Kosovës, ju njoftojmë me raportin e ekspertizën lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me Pisje Laboratorike dhe Paisje të tjera për nevojat e UP-së" Lot 4, me nr. të prokurimit: 90400/16/022/111**, iniciuar nga autoriteti kontraktues: (AK)– **Universiteti i Prishtinës,** si dhe me përgjigjen ndaj pretendimeve ankimore të OE ankues: **"Pharmachem"-Dega në Kosovë** - Prishtinë, me numër protokollit: **33/17.**

Konform nenit *113 dhe 114*, Pjesa IX e LPP-së, eksperti shqyrtues i pavarur , ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë si dhe kërkesën e AK-së, dhe ka konstatuar si më poshtë:
AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë,të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

		02.02.2017		03.02.2017		13.02.2017
Nënshkrimi i ekspertit		*Data e autorizimit të ekspertizës*		*Data e fillimit të ekspertizës*		*Data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën: **31.01.2017**, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. **409/16,** e parashtruar nga OE: **"Pharmachem"-Dega në Kosovë** - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me Pisje Laboratorike dhe Paisje të tjera për nevojat e UP-së" Lot 4, me nr. të prokurimit: 90400/16/022/111**, iniciuar nga autoriteti kontraktues: (AK)– **Universiteti i Prishtinës**
Konform nenit 113, të Ligjit Nr. 04/L-042, si dhe konform njoftimit të OSHP-së të datës: 19.11.2014 me nr. prot. 848/14. Eksperti Shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK) – **Universiteti i Prishtinës**

N.111,LPP - Operatori Ekonomik Ankues: "Pharmachem"-Dega në Kosovë - Prishtinë.

Pikat e Ankesës:

Neni 7 Barazia ne Trajtim /Jo-Diskriminimi -pika 1,2,6

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve-pika 4

Neni 115, Njoftimi i Kompanisë (pharmachem) me mendimin e ekspertit nga ana e (AK) pikat ,1,2,3,4,5.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Pas qasjes se realizuar per kontrollim te dokumentacionit tenderues me date 22.01.2017 deklaroi sikurse ne vijim:

1 -Autoriteti kontraktues me date 7.11.2016 na njofton neve si kompani pjesëmarrëse ne tender - "Pharmachem dega ne Kosove" me letër standarde se tenderi yne është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe se ne jemi shpërblyer me kontrate.

2. -Me date 11.11.2016 na njofton me email për pezullim te aktivitetit te prokurimit përshkak të ankesës se OE Ledi Med.

3.AK nuk na njofton fare me përmbajtjen e ankesës se OE Ledi Med.

4. Me 20.12.2016 (AK) e shpall ne KRPP njoftimin për anulimin e dhënies se kontratës për OE fitues "Pharmachen"ne njoftim për anulim shkruan se pregaditja e njoftimit është ber me date 15.12.2016. Ne njoftim për anulim te dhënies se kontratës (AK) ne arsyetimin e njoftimit per anulim shenon se egziston vendimi I OSHP qe kerkon anulimine dhenjes se kontrates , e qe ne fakt ne ket faze (AK vepron sipas mendimit te ekspertit te OSHIP ref. 409/16 date 12.12.2016

5. Me 28.12.2016 del vendimi i OSHP PSH nr. 409/16.qe lenden e dergon ne rivlerësim

6.Me 17.01.2017 njoftimi me letër standarde nga AK per eliminim , me 18.01.2017 nioftimi per dhenjen e kontrates ne KRPP per OE Ledi Medsh.p.k

7.Me 18.01.2017 Pharmachem ben ankes-kerkes pran(AK)per qasje ne dokumentacion tenderus

8. Me 20.01.2017 lejohet qasja ne dokumentacion .Kontrollojm dokumentacionin dhe ca dokumente foto kopje i marrim per krahasim,gjithashtu kam kerkuar nje kopje te vendimit te Panelit shqyrtues PSH nr.409/16 pergjigja eshte se nuk e kishin ket dokument fare ne dosje dhe se kjo ceshtje verteton se deri ne ket faze (AK) ka veprue me mendim te ekspertit ref409/16 i cili na është prezantuar i vetëm deri me tani???. prandaj keto veprime te pa drejta tregojn se: Autoriteti kontraktues duke ber shkelje sipas neneve të cekura me lart te Ligjit LPP Nr.04/ L-042 e diskriminon OE Pharmachem-dega në Kosovë si pjesmarrse ne ket procedure te prokurimit dhe e favorizon OE "Ledi Med" duke e shperblyer me dhenje te kontrates, Prandaj ne kerkesen tone per ryshqyrtim AK na pergjigjet me vendim ,ku ne nuk jemi te kenaqur me vendimin e AK dhe bejme ankese se ne OSHP, pershkrimi i fakteve dhe i shkeljeve sikurse ne vijim ne vijim:

- Autoriteti kontraktues e favorizon kompanin fituese te tenderit duke e shperblyer me dhenje te kontrates OE "Ledi Med ", edhe pse OE Ledi Med ka dorzuar Tenderin e pakompletuar me dokumentacion perkates te kerkuar sipas dosjes se tenderit. Kompanise fituese i mungojn kto dokumente :

1.Katalogu i paisjeve -Katalogu i paisjeve si dokument kyc ne ket proces nuk eshte i kompletuar dhe nuk i permban pozicionet e definuara sipas dosjes se tenderit e qe duhet te jete i nenvizuar -shenuar, sipas pozicioneve te ofertes financiare(pershkrimi i cmimeve) .Çdo pozicion i ofertuar i ofertes financiare duhet te jete i shenuar me kod dhe foto ne Katalog. OE Fitues ne faqen e katalogut e shenon vetem pozicionin e kerkuar sipas Ofertes financiare por nuk tregon se cka ofron sipas katalogut nuk e nenvizon kodin adekuat ne katalog qe i pergjigjet paisjes se ofertur, sepse ka shum paisje qe kerkohen si Set (Komplet) dhe nuk dihet sa cka eshte obligative per liferim cka permban kompleti. Kjo munde te vertetohet me shiqimin e Katalogut te Tenderit OE Ledi Med, nuk gjindet asnji kod i paisjeve i shenuar sipas dokumentit tenderues. (me perjashtim poziconi 18 nenvizohet kodi por jo edhe paisja)

2. Oferta financiare e OE Ledi Med sh.p.k nuk eshte e kompletuar -Pozicioni 14 i ofertuar nuk eshte komplet. Ky pozicion ne dokument pershkrimi i cmimeve (dokument tenderues) kerkohet si set komplet e ne katalogun e OE Ledi Med Nuk shifet se prej ckafit perbehet ky set i ofertuar,i mungojn fare prezentimi i substacave kimike qe jane pjese e ketij seti -perberja e setit eshte e pa njohur.Me ket set duhet te ofertohet fenolftaleina si substanc kimike ,Set testi i Karbonateve mungon. (Metoda eshte e standardizuar sipas EN,dhe kjo nuk mund te ndryshohet sepse nese mungon dicka nuk mund te kryhet analiza e karbonateve)- Nuk eshte sipas dojes se tenderit.

-Pozicioni i 18 i ofertuar nga OE Ledi Med nuk eshte sipas kerkeses ne dosje te tendrit .AK ne dosje te tenderit kerkon peshore me kapacitet 1000/5000g dhe rezolucion 0.01/0.1 OE Ledi Med per ket pozicion oferton peshoren Tip v072-02 me kapacitet 800/5500g qe nuk eshte e njejt me ate qe kerkohet,kjo peshore ka kapacitet me te vogel se qe eshte kerkuar.argumenti katalogu i OE Ledi med nuk e di se si eka leshuar ket fakt Eksperti i OSHP edhe pse ai ket gje e konstaton ne mendimin e dates 12.12.20016, duke shënuar se ankuesi "Ledi med" oferton peshoren me kapacitet 800/5500g (nuk i plotëson kushtet)-Ne tender kerkolet re kapacitet 1000/5000g.

OE Pharmachem per ket pozicion oferton poz. 18. RADWAG peshore PS.6000RI qe i plotson

kerkesat e AK. sipas tenderit.

-Pozicioni 24 nuk eshte i definuar fare ne katalog. Ne dokument tenderues kerkohet paisje si Set komplet e qe eshte e perber prej disa paisjeve te shenuar me code te ndara. Nga ajo qe ofron OE Ledi Med nuk shifet se prej ckafit perbehet kompleti cili eshte seti codet kjo vertetohet me shiqim ne. Katalogune ofertuar OE, Ledi med.

-Pozicioni i 37 edhe kjo paisje kerkohet si set (komplet),nga ajo qe prezenton Ledi med nuk precizohet se cka permban seti,dhe gjithcka eshte e pa kjart. Shif katalogun e prezentuar nga Ledi Med.

-Pozicioni 43.Spectrofotometer kjo paisje ofertohet nga OE Ledi med dhe eshte Tip DR2800 i cili per fat te keq nuk prodhohet nji kohe te gjate dhe eshte nxjerr nga prodhimi shum vite me pare.nuk e di se ku ka me e gjet OE Ledi Med kur ky instrument nuk prodhohet. Argument vertimi i prodhuesit Hach lange qe tregon se Modeli DR 2800 nuk prodhohet shum vite me pare.qe do te thote se furnizimi me te nuk eshte i mundeshem. OE Pharmachem me koh e ka verejt ket ceshtje ne kontakt me prodhuesin dhe me kerkese per informata shtese te AK ne vitin 2015 e skjaron ket ceshtje dhe pyet AK se a mund te ofertohet modeli tjeter DR1900 icili eshte me i peraferti me instrumentet tjera qe prodhohen nga i njeti prodhues paso pergjegja e AK po mundet.dhe Pharmachem pastaj plot dy vjet oferton me te njejtin instrument dhe nuk merr asnji verjtje kurse ne rastin e fundit AK e shpall te paergjegjshem dhe e pranon oferten e OE Ledi med me model DR2800 tip icili nuk prodhohet nji kohe te gjat eshte jashyt e perdorimit ,kjo eshte e cuditshme Habit fakti se si AK nuk e ka njoftu Ekspertin e OSHP per ket ceshtje gjat shqyrtimit te lendes.Argument kerkesa per informata shtese prane AK nga Pharmachem 2015.Pharmachem aplikon edhe 5 her tjera gjer me tani dhe nuk ka pas verejtje per vec tani kur eliminohet padrejtsisht si papershtatshem,argument tjeter per ket pike eshte Dokumenti i marrun nga prodhuesi Hach Lange Se Modeli DR 2800 nuk Prodhohet nji kohe te gjat dhe si zavendsim tregut i ofrohet modeli me i perafert DR1900.Prandaj ketu ka mungese te informacionit per OSHP sepse po ta kishte ket informat OSHP vendimi do te ishte tjeter . Ne dokument e ofruar nga prodhuesi Hach Lange i keni kontaktet e prodhuesit ku mund te vertetoni ket ceshtje.

-Pozicioni 45 Termostat eshte ne dy verzione ne kalog i prezentuar nga OE Ledi Med nuk tregon se cilin prej tyne e oferton nuk lejohet kjo duhet te shenoi ne katalog cilin e oferton.Argumenti shifkatalogune ofertuar.

-Pozicioni 46 sipas dokumentit tenderues kerkohet paisja si set OE ledi med nuk e paraqet si set foto por vetem paisjen kryesore, mungon seti (canta.substancat kimike,senzori.elektroda etj.) Duke marr parasysh mungesen e informacionit nga AK per ne gjate procedures se ankimimit per ket lend nuk na eshte mundsuar prezentimi argumenteve relevante pran OSHP se si e kemi ofertuar poz.43 cila eshte arsya.Po te kishim pas ket mundesi do te kishim nji epilog tjeter krejtsisht .Eshte e cuditshme se si AK nuk e njofton ekspertin e OSHP,OSHP se e ka ndru specifikacionin e tenderit me kerkese per Informata shtese nga OE Pharmachem,argumentim kerkesa per informata shtese prane AK. AK-eshpall anulimin e dhenijes se kontrates OE Pharmachem me "mendim te ekspertit "10 dite para vendimit nga Oshp. nuk e pret nxjerrjen e vendimit te panelit shqyrues te OSHP,nuk e njofton OE me vendimin e AK ne raport me Mendimin e Ekspertit te OSHP.Krejt kjo qe eshte thene me larte tregon se AK Padrejtsisht e favorizon OE Ledi Med sh.p.k prej fillimit te procesit te evaluimit te tenderit e deri ne procesin e rivlersimit -Vendimi i OSHP PSH.nr 420/16 e permend vetem pozicionin 43.si jo adekuat dhe e dergon lenden ne rivlerësim .

-AK ne njoftimin me leter standarte thot se sipas vendimit te OSH Poz.18 dhe 43. Nuk jane ashtu sic kerkohet,shenimet nuk perputhen.

-AK nuk na informon per vendimin AK ndaj mendimit te ekspertit te OSHP (neni i 15 i LPP) dhe ne ket menyr na mohon te drejten per prezentimin e fakteve pran panelit shqyrtues te OSHIP, ???.

Nese analizohet e ter kjo qe eshte then me lart shifet kjart se shkeljet e shenuara te LPP nga AK jane evidente Rivlesimi i perfunduar nuk ashte idrejt shif Raportine Rivlersimit ne dokumente. Ne keto rethana kemi ndryshim jo te drejt te shpalljes se fituesit per ket lend dhe favorizim te padrejt te OE Ledi Med. Prandaj kerkojme nga OSHP qe te anuloi ket aktivitet te prokurimit dhe lenden ta dergoi ne ritenderim sepse AK nuk e ka zbatuar vendimin e OSHP PSH nr.420/16 per rivlesim te mirfillt dhe te drejt.

Dëmet materiale:
Demi material 60000.00euro mos realizimi i planit 2016.Demtimi i reputacionit te kompanise.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP:	29.09.2016
Lloji i procedurës së aplikuar:	Procedurë e Hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:	Furnizim/vlerë e Madhe
Vlera e parashikuar e kontratës:	55,000.00 Euro
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë):	20.10.2016
Data e hapjes së ofertave:	20.10.2016
Data e njoftimit të Dhënies së Kontratës në faqen e KRPP-së	17.01.2017

Kriteret për vlerësim:

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

a. **Një deklarate e shkruar nën Betim**, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2.
Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërise do të kërkohen nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Në rast të dështimit të dorëzimit te këtij dokumenti, tenderi në fjalë do të refuzohet

Dokumentet te cilat do te kërkohen si dëshmi për përmbushje te kërkesave te pranueshmërise janë me se vijon:

a. Për situatën referuar pikës 6.2 [a,c,d, e dhe f] dhe pikës 6.3 [a,b dhe d], **vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente** apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit.

b. Për situatën referuar pikës 6.3 [h (kontributi i sigurimit social), i dhe k] certifikate e lëshuar nga autoriteti kompetent apo operatori publik që një situate tillë nuk ekziston.

c. Për situatën referuar pikës 6.3 [h (tatimit)], **vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore** e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit *[para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës]*

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. **Deklarata nën Betim** - obligative
2. **Vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente** - vetëm për fituesin para dhënies se kontratës;
3. **Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore** - vetëm për fituesin para dhënies se kontratës

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

1. Regjistrimi i OE në regjistrin profesional, komercial ose korporatës në vendin e themelimit është i detyruar të paraqesë certifikatën e regjistrimit të njësisë përhershme.
2. Certifikata e regjistrimit të TVSH-së
3. Certifikatën e Regjistrimit të Numri Fiskal te lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës

Dëshmia të kërkuara dokumentare:

1. Një kopje e certifikatës së biznesit te bashkangjitura me te gjitha veprimtarit përkatëse;
2. Një kopje të certifikatës se TVSH;
3. Një kopje të certifikatës se numrit fiskal;

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar ;

1. Raporti i auditimit nga një kompani e licencuar e auditimit për kontrollim, apo nga një auditor i licencuar i pavarur për vitet (2013,2014 dhe 2015).

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. - Kopja e pasqyrave financiare të audituara për 3 vitet e fundit (2013,2014 dhe 2015) si dhe raporti i auditorit për pasqyrat përkatëse (Auditori i Licencuar ose ndonjë Kompani e Auditimit-duhet ti bashkëngjitet edhe kopja e licencës së Auditimit e noterizuar) për te gjitha Lotët.

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional;

1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses së paku tri kontrata të natyrës se ngjashme në tri vitet e fundit (2013, 2014, 2015).

2. Prezantimi i produkteve te ofruara me katalogë/broshura.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

*1)*Për piken 1. Një Listë e furnizimeve të natyrës se ngjajshme të realizuara në tri vitet e fundit duke saktësuar furnizimet e kryera, shumën e kontratës vendin, datën si dhe nr e prokurimit, kjo listë duhet te jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga kompania (origjinal), po ashtu duke i bashkangjitur së paku tri referencat përkatëse ose raportet e pranimit si dëshmi se kontrata është përmbushur me sukses. (kopje).Për të gjitha Lotot ;3,4,5dhe 6.

2. Për piken 3. Katalogu / broshura për prezantim te produkteve te ofruara për secilin Lot veç e veç po ashtu çdo artikuj duhet te jete i nënvizuar për secilin pozicion te specifikimit teknik (kopje). Për të gjitha Lotot ; 3,4,5dhe 6 ,e nënshkruar dhe e vulosur nga O.E.

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatoret ekonomik	Vendi	Çmimi në total €	Vërejtje
1.	"LEDI MED" sh.p.k.	Prishtinë	54,055.00 €	JO
2.	"Farmachem"	Prishtinë	51,957.95 €	JO

Sipas Procesverbalit të Hapjes së Tenderëve me datën: 20.10.2016, konstatohet se në hapjen e ofertave kanë marrë pjesë përfaqësuesit e 2 (dy) OE për Lot 4, ku është lexuar emri i operatorit ekonomik, vendi dhe çmimi. Procesverbali i hapjes është nënshkruar nga anëtarët e komisionit të hapjes pranë AK-së.

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, si në vijim:

- - Kryesues i komisionit – Arton Dautaj
- - Anëtar i komisionit - Ali Muriqi
- - Anëtar i komisionit – Besim Ajvazi

Data e fillimit dhe mbarimit të vlerësimit:.....19.12.2016-12.01.2017

Data e nënshkrimit te raportit nga zyrtari kryesor i prokurimit:.....12.01.2017

Raporti i komisionit vlerësues:

Komisioni i vlerësimit rekomandon ne bazë të vendimit me nr.409/16 i datës 30.12.2016 rekomandon si fitues kompaninë SH.P.K. "LEDI MED", e cila ne bazë të këtij vendimi është e përgjegjshme me çmim 54,055.00 €.

Analiza dhe sqarimet e ekspertëve shqyrtues (N. 113, 114)

Ekspertet shqyrtues pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Sqarimi 1: Autoriteti Kontraktues – **Universiteti i Prishtinës,** gjatë këtij aktiviteti të Prokurimit: **"Furnizim me Pajisje Laboratorike dhe Pajisje të tjera për nevojat e UP-së" Lot 4, me nr. të prokurimit: 90400/16/022/111,** ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është furnizim, kontratë publike, me vlerë të madhe.

Operatori ekonomik ankues: **"Pharmachem"**- me datë: 23.01.2017, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK për këtë aktivitet të prokurimit kundër njoftimit për dhënie të kontratës me pretendimet ankimore se është bërë shkelje të dispozitave të LPP-së, dhe atë të nenit: 7, 59 dhe 115 të LPP-së në fuqi.

AK- **Universiteti i Prishtinës** me datën 26.01.2017, ka kthyer përgjigjeje ndaj operatorit ekonomik ankues në këtë aktivitet të prokurimit dhe ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim.

OE ankues për të njëjtin aktivitet të prokurimit ju është drejtuar OSHP-së me ankesë me datën: 31.01.2017, kundër OE të rekomanduar për dhënie të kontratës.

Analiza dhe konstatimet e ekspertit teknik, sipas nenit 18 pika 13 e Rregullores së Punës së OSHP-së.

Gjatë analizimit dhe shqyrtimit të këtij aktiviteti të prokurimit, bazuar në dokumentacionin që Ekspertja teknike ka pasur në dispozicion dhe ka konstatuar, si në vijim.
Gjatë shqyrtimit të kësaj lënde kam studiuar se kërkesat e AK–UP-së dhe Përshkrimin e specifikacioneve teknike të bërë në mënyrë profesionale dhe nuk ka vend për dyshime.

Eksperti shqyrtues teknik - Sqarimi 2:
Pretendimet ankimore të OE "Pharmachem" për pozicionet ose artikujt nr.18,24,37,43,45 dhe 46 nuk qëndrojnë, pasi që OE "LEDI-MED", e posedon katalogun me përshkrime për secilin pozicion.

Operatori ekonomik "Ledi-Med" sh.p.k. te pozicioni nr.18 , ka ofrua peshoren matëse me specifikacion sipas kërkesës 800/5500G X 0,01/0,1G, që do të thotë se është brenda diapazonit të matjes 800-5500 gram qe do të thotë se kjo matë peshën 1000-5000 si dhe ka precizitetin 0.01/0.1 g ku OE "Pharmachem" prezanton peshoren e tipit WLC6/A2 RADWAG ku është ne data sheet tregon vetëm kapacitetin e matjes max 6 kg ose 6000g e jo edhe minimumin e saj siç janë kërkuar në pozicionin 9.1 pika 9.2 të FDT-së, dhe nuk e plotëson këtë kriter për produktin e ofruar me tilla karakteristika.

Eksperti shqyrtues teknik -Sqarimi 3:
Duke u bazuar në pretendimet ankimore të OE: "PHARAMACHEM" për pozicioni nr.24 Flat jacks pajisje për kontrollin e rezistencës dhe E-modulit për muratura me metoda të pllakave shtypëse dhe se OE "LEDI_MED" i plotëson kriteret sipas FDT-së pozicioni 9.1 pika 9.2 te dëshmitë e kërkuar dokumentare pika 2. Specifikacionet teknike të detyrueshme. Konstatim im si eksperte teknike është se OE: "LEDI-MED" i plotëson këto kriter sipas FDT.

Eksperti shqyrtues teknik -Sqarimi 4:
Sa i përket pretendimit ankimor të OE: "PHARAMACHEM" se OE:"LEDI-MED" nuk ka ofrua artikullin Nr.37 me specifikacion të kërkuar nga AK-UP si set (komplet) nga katalogu shihet shumë e qartë pajisja matëse OEDOMETER e kompletuar me aksesorë.

Eksperti shqyrtues teknik -Sqarimi 5:
Sa i përket pretendimit ankimor të OE: "PHARAMACHEM" se OE:"LEDI-MED" ka ofrua artikullin Nr.43 tipit i cili nuk prodhohet me nga Lange HACH për mua është e pa bazë sepse ne nuk kemi një argument ,asnjë email ose konfirmimim nga OE "PHARMACHEM" prej Lange HACH për të na bind se nuk prodhohet një tip i tillë dhe nga AK është kërkua në dosje Spektri me gjatësi valore 340-900nm, cilin e ka ofertua edhe i rekomanduari për shpërblim me kontratë, OE "LEDI-MED" sh.p.k.
Pajisja matëse ose spektrophotometri i ofruar nga operatori i rekomanduar me kontratë i plotëson kriteret që janë kërkuar në specifikimet teknike.
Përfundimisht konstatim im si eksperte teknike është se OE: "Pharmachem" nuk i plotëson kriteret sipas FDT-së.

Eksperti shqyrtues teknik -Sqarimi 6:
Te pozicioni 45 si pretendim ankimor i OE: "PHARAMACHEM", se nuk ka cek se cilin tip e oferton nga katalogu që ka prezantua OE"LEDI-MED" sh.p.k shihet se ka rrumbullakosu modelin e tipit LT 200-2 thermoreactor ose thermostat me dy blloqe COD DHE TOC ku me të njëjtin tip termostatit ka ofertu edhe OE ankues "Pharmachem".

Eksperti shqyrtues teknik -Sqarimi 7:
Pozicioni 46 si pretendim ankimor i fundit nga OE"PHARMACHEM" nuk qëndron, sepse OE "LEDI-MED" ka të prezantuar katalogun si dhe ka të nënvizuar me ngjyre të verdhë pajisjen matëse tipit sensION+MM150 Portable Multi Meter Kit me të gjithë aksesoret e kërkuar sipas FDT nga AK.

Mendimi i ekspertëve shqyrtues:

Gjatë analizimit të dosjes së tenderit dhe procedurës së zhvilluar për aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me Pajisje Laboratorike dhe Pajisje të tjera për nevojat e UP-së"- Lot 4, me nr. të prokurimit: 90400/16/022/111**, i rekomandojmë panelit shqyrtues që ankesën e operatorit ekonomik ankues të refuzohet si e pa bazuara, ndërsa Autoriteti Kontraktues të vazhdoj me procedurat e mëtutjeshme.